

Artan Mirashi ka lindur më 31.08.1962 në Qytetin e Maliqit.

Z. Mirashi ka kryer studimet e larta në periudhën 1981-1986, në Universitetin e Tiranë Fakulteti i Gjeologji Miniera Diplomuar Inxhinier Gjeolog. Në vitin 2006 ka përfunduar studimet e larta në Universitetin e Tiranës Fakulteti i Drejtësisë ku është Diplomuar Jurist. Për periudhën 2006-2008 ka përfunduar programet e studimit “Mastër në Ekonomi e Politika Agrare” pranë Fakultetit të Ekonomisë Universiteti Bujqësor Tiranë. Në datë 08.04.2015 është Certifikuar në kualifikimin Pasuniversitar “Vlerësimi i Pasurive të Paluajtshme” pranë Fakulteti Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik Tiranës.

Aktualisht ka një eksperiencë pune prej 29 vjetësh si “Auditues i Jashtëm”, që nga viti 1992 kur ka filluar punën në Kontrollin e Lartë të Shtetit. Për periudhë nga 1986 deri vitin 1992 eksperiencia konsiston në punën si inxhinier në zbulimin e hollësishëm të Mineraleve dhe ndjekjen e financimit të punimeve kapitale minerare.

Për periudhën nga viti 1992 e aktualisht në punën si Auditues i Jashtëm ka marrë pjesë në trajnime, konferenca, seminare, të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, në lidhje me çështje të auditimit të jashtëm publik dhe institucioneve supreme të auditimit.

Në vitin 2007 dhe në vitin 2011 trajnime mbi “Prokurimin Elektronik Publik” dhe “Marrëveshjet kuadër, koncesionet dhe kriteret për dhënien e kontratës” nga USAID-APP dhe IPA. Në vitin 2008 ka qene “Pjesëtar në grupin e punës të reformës institucionale” Mbi aftësitë dhe njohuritë e fituara në teori dhe praktikë të reformave institucionale, udhëhequr nga NAO Angli. Në vitin 2012 trajnime Mbi “Auditimin e Performancës” nga CEF Lubjana Slloveni, si dhe nga NIK Polak. Në vitin 2017 trajnim “Hyrje në auditimin mjedisor” Programi i 5-të Ndërkombëtar i Trajnimit nga SAI India dhe INTOSAI.

Prej vitit 1992, ajo ka ushtruar pozicionin e Audituesit, Audituesit të Lartë e më pas Kryeaudituesit në departamente auditimi dhe aktualisht pranë Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, mban pozicionin Kryeaudituesit në këtë departament.